



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:300636

Datë: 12.03.2024

Numri i dokumentit: 05438786

CN.nr.10/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, gjyqtari i vetëm Besnik Bislimaj, në çështjen kontestimore të paditësit – propozuesit M. M., nga Gjilani, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson, Q. Q., nga Prishtina, Bulevardi “D... e K.”, Objekti ../6, Ulpianë, kundër të paditurve kundërshtarëve të sigurimit, M. P., M. P. (M.) dhe M. P. (M.), nga Prishtina, tani me vendqëndrim në Serbi me adresë të panjohur, të cilët i përfaqëson me autorizim avokat N. K. nga Prishtina, për vërtetimin e të drejtës së pronësisë, duke vendosur sipas propozimit për përsëritjen e procedurës të paraqitur nga të paditurit, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.5016/2019 i datës 11.06.2021, me datë 12.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si i pathemeltë propozimi për përsëritjen e procedurës i paraqitur nga i autorizuari i të paditurve, av. N... K. nga Prishtinë, i parashtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.5016/2019 i datës 11.06.2021.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimi e ankimuar C.nr.5016/2019 i datës 11.06.2021, ka vendosur: I. CAKTOHET MASA E SIGURIMIT dhe JU NDALOHËT të paditurve - kundërshtarëve të sigurimit, M. P., M. P. (M.) dhe M. P. (M.), nga Prishtina, tani me vendqëndrim në Serbi me adresë të panjohur, që të tjetërsojnë-shesin, apo të ngarkojnë me ndonjë barrë juridike, patundshmërinë e cila evidentohet si parcelë kadastrale-7, Fleta poseduese nr..... vendi i quajtur “L.. e v....”, me kulturë arë e klasës së parë, në sipërfaqe prej ... m2, ZK Prishtinë, deri në plotfuqishmërinë e kësaj çështje kontestimore, apo deri në ndonjë

vendim tjetër të kësaj gjykate. II. DETYROHEN Zyra Kadastrale në Prishtinë dhe Oda Noterëve në Prishtinë, që ndalimin nga paragrafi I të dispozitivit të këtij aktvendimi, ta evidentojnë në regjistrat përkatës të tyre.

Kundër këtij aktvendimi, të paditurit përmes të autorizuarit të tyre, av. N... K... nga Prishtina, ka paraqitur propozim për përsëritje të procedurës, duke propozuar që Gjykata e Apelit, të aprovoj propozimin për përsëritjen e procedurës, ndërsa aktvendimin C.nr.5016/2019 i datës 11.06.2021

Përgjigje në propozimin për përsëritjen e procedurës ka parashtruar paditësi me propozim që të refuzohet si i pa bazuar propozimi për përsëritjen e procedurës.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit në kuptim të nenit 235 dhe 239.1 të LPK-së, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të propozimit për përsëritjen e procedurës së parashtruar nga e paditura Komuna e Shtërpcës, gjeti se:

Propozimi për përsëritjen e procedurës është i pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi – propozuesi i masës së sigurimit M. M. nga Gjilani, pranë gjykatës së shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të M. P., M. P. (M.) dhe M. P. (M.), nga Prishtina, tani me vendqëndrim në Serbi me adresë të panjohur, të cilët i përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm av. A... V. nga Prishtina, i caktuar sipas aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr. 5016/2019 datë 18.05.2020. me objekt të kontestit, vërtetim i pronësisë me propozim për caktimin e masës së sigurisë.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas propozimit të paditësit për caktimin e masës së sigurisë, pas mbajtjes së seancës dëgjimore për masë të sigurisë, dëgjimit të palëve ndërgjyqëse dhe administrimit të provave ka marrë aktvendimin C.nr. C.nr.5016/2019 i datës 11.06.2021, duke e aprovuar në tërësi propozimin për caktimin e masës së sigurisë, duke vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Gjykata e Apelit ka vlerësuar pretendimet e propozuesve të paraqitura në propozimin për përsëritjen e procedurës, se kërkesa bazohet në nenin 232 paragrafi 1, pika a) dhe c) të LPK-së, por konsideron se propozimi për përsëritjen e procedurës nuk është i bazuar në asnjërën nga këto dispozita. Në rastin konkret nuk mund të gjejnë zbatim dispozitat e nenit 232 paragrafi 1, pika a) LPK-së, pasi paragrafi 1, pika a) të nenit 232, përcakton se *“në qoftë se palës me veprim të kundërligjshëm, e sidomos në rast të mos thirrjes për në seancë nuk i jepet mundësia që të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes kryesore”*. Në rastin konkret nuk mund të flitet për mos thirrje në seancë, pasi gjykata e shkallës së parë duke vepruar në përputhshmëri të dispozitave të procedurës Kontestimore, ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për gjetjen e adresës së të paditurave dhe në pamundësi për gjetjen e adresës së tyre, me aktvendim C.nr. 5016/2019 datë 18.05.2020, të paditurve i cakton përfaqësues të përkohshëm av. A... V., i cili në kuptim të nenit 82 të LPK-së, i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjor, Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë me vendimin e ankimuar ka vendosur vetën në kërkesën për caktimin e masës së sigurisë, që do të thotë se gjykata e shkallës së parë nuk ka vendosur për çështjen kryesore

dhe në këtë rast vendimi i atakuar nuk mund të paragjykoj çështjen kryesore sepse i njëjti vendim ka karakter procedural edhe pse me të është caktuar masa e sigurisë dhe se i njëjti në çdo kohë mund të ndryshohet me propozimin e palëve apo në çdo kohë kur pushojnë shkaqet për të cilët është caktuar masa e sigurisë. andaj, duke u nisur nga kjo gjendje e shkresave të lëndës, gjykata e Apelit vlerëson se në rastin konkret nuk ka bazë për përsëritjen e procedurës, pasi që të paditurve nuk ju ka mohuar e drejta e tyre për tu deklaruar në lidhje me çështjen për të cilën janë paditur nga paditësi, pasi që kjo çështje është ende në fazën fillestare dhe nuk mund të flitet për çështje të përfunduar me aktgjykim apo aktvendim të formës së prerë siç përcakton neni 232 par. 1 të LPK-së.

Gjithashtu gjykata e Apelit i vlerëson si të pa bazuara pretendimet e të paditurve në lidhje me shkaqet e përsëritjes së procedurës nga neni 232 par. 1 pika c), i cili parasheh që *“në qoftë se vendimi përfundimtar i gjykatës është bazuar në deklarata të rreme të dëshmitarëve apo të ekspertëve ose në dokumentin që është falsifikuar apo në të cilin është verifikuar përmbajtja e pasaktë”*. Në rastin konkret pretendimet e të paditurve në lidhje me deklarime të rreme të dëshmitarëve dhe ekspertëve dhe falsifikim të dokumenteve janë të pa bazuara pasi që (të paditurit) propozuesit e përsëritjes së procedurës nuk kanë ofruar asnjë provë për të vërtetuar një fakt të tillë, pasi që për të vërtetuar një fakt të tillë duhet që doemos dëshmitarët, apo ekspertët të shpallen fajtor për veprë penale me aktgjykim të formës së prerë dhe jo vetëm të potencohet apo të aludohet se të njëjtët, dëshmitarët apo edhe ekspertët kanë deklaruar rrejshëm, pasi që nuk është vërtetuar me vendim të formës së prerë, apo të paktën të paditurit kanë dështuar të sigurojnë prova. Andaj në rastin konkret për gjykatën e Apelit, nuk janë plotësuar kushtet ligjore për përsëritje të procedurës nga neni 232 par. 1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit konform nenit 239 paragrafi 1, të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke refuzuar përsëritjen e procedurës.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CN.nr.10/2023, me datë 12.03.2024

Gjyqtari,
Besnik Bislimaj, d.v

Këshilla juridike: Kundër këtij aktvendimi, pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, kolegjit të Gjykatës së Apelit.